


Climate 4000i

CL4000iU W 26 E | CL4000iU W 35 E | CL4000i W 52 E | CL4000i 26 E | CL4000i 35 E | CL4000i 52 E

bg	Климатична сплит система	Ръководство за обслужване за потребителя	2
cz	Splítová klimatizační jednotka	Návod k obsluze pro provozovatele	11
et	Splít-kliimaseade	Kasutusjuhend seadme kasutaja jaoks	19
el	Κλιματιστικό Split_type	Οδηγίες χρήσης για τον υπεύθυνο λειτουργίας	27
en	Split air conditioner	Operating instructions for users	36
hr	Mono splít klima-uređaj	Upute za uporabu za korisnika	44
hu	Splít klímakészülék	Kezelési útmutató az üzemeltető számára	52
it	Condizionatore splít	Istruzioni per l'uso per il gestore	60
lt	"Split" oro kondicionavimo sistema	Naudojimo instrukcija naudotojui	69
lv	Splít kondicionieris	Lietošanas instrukcija	78
mk	Сплит клима уред	Упатства за ракување за корисникот	87
pl	Urządzenie klimatyzacyjne splít	Instrukcja obsługi dla użytkownika	96
ro	Aparat de aer condiționat	Instrucțiuni de utilizare destinate utilizatorului	105
sk	Splítové klimatizačné zariadenie	Návod na obsluhu pre prevádzkovateľa	114
sl	Splít klimatska naprava	Navodila za uporabo	123
sr	Splít klima uređaj	Uputstvo za upotrebu za korisnika	131
sq	Kondicioner Splít	Manuali i përdorimit	140
tr	Splít tipi klima cihazı	Kullanıcılara Yönelik Kullanma Kılavuzu	148
uk	Спліт кондиціонер	Інструкція з експлуатації для користувача	156



0010034218-001



Përmbajtja

1	Shpjegimi i simboleve dhe udhëzimet e sigurisë	140
1.1	Shpjegimi i simboleve	140
1.2	Këshilla të përgjithshme sigurie	141
1.3	Shënimet në këtë manual	141
2	Të dhëna për produktin	141
2.1	Deklarata e konformitetit	141
2.2	Të dhënat teknike të telekomandës	141
2.3	Përdorimi me kondicioner Multisplit	141
2.4	Informacion për freonin	142
3	Përdorimi	142
3.1	Përmbledhje e njësive të brendshme	142
3.2	Përmbledhje e telekomandës	142
3.3	Përdorimi i telekomandës	143
3.4	Caktimi i modalitetit kryesor të punës	143
3.5	Konfigurimi i kohëmatësit	144
3.6	Funksione të tjera	144
3.6.1	Caktimi i funksionit të lëvizjes	144
3.6.2	Çelësi i ekranit dhe i sinjalizuesit të alarmit (Mute Mode)	144
3.6.3	Funksionet e kursimit të energjisë	144
3.6.4	Ulja e zhurmës (Silent Mode)	144
3.6.5	Ftohje/ngrohje e përsheptuar	144
3.6.6	Vetëpastrimi (I clean)	145
3.6.7	Mbrojtja ndaj ngricës (8 °C Heating)	145
3.6.8	Kyçja e tasteve	145
3.6.9	Funksionet e avancuara të punës	145
4	Zgjidhja e problemeve	146
4.1	Gabimet me tregues (Self diagnosis function)	146
4.2	Gabime pa tregues	146
5	Mirëmbajtja	147
5.1	Ndërrimi i baterive	147
5.2	Pastrimi i pajisjes dhe i telekomandës	147
5.3	Pastrimi i filtrave të ajrit	147
5.4	Lënia pa punë për kohë më të gjatë	147
5.5	Modaliteti manual	147
6	Mbrojtja e ambientit dhe hedhja	147

1 Shpjegimi i simboleve dhe udhëzimet e sigurisë

1.1 Shpjegimi i simboleve

Këshilla sigurie

Tek këshillat paralajmëruese, fjalët sinjalizuese karakterizojnë llojin dhe ashpërsinë e pasojave, nëse nuk respektohen masat për parandalimin e rreziqeve.

Fjalët e mëposhtme sinjalizuese janë të përcaktuara dhe mund të jenë përdorur në dokumentin që keni para:


RREZIK

RREZIK do të thotë që mund të shkaktohen dëme të rënda dhe deri me rrezik për jetën.


PARALAJMËRIM

PARALAJMËRIM do të thotë që mund të shkaktohen dëme të rënda deri në rrezik për jetën.


KUJDES

KUJDES do të thotë që mund të shkaktohen dëme të lehta deri të mesme të rënda në persona.





KËSHILLË

KËSHILLË do të thotë që mund të shkaktohen dëme materiale.

Informacione të rëndësishme



Informacionet e rëndësishme pa rreziqe për njerëzit ose sendet shënohen me simbolin informues Info.

Simboli	Kuptimi
	Paralajmërim për substancat e djegshme: freoni R32 në këtë produkt është një gaz me djegshmëri të ulët dhe toksicitet të ulët (A2L ose A2).
	Mbani doreza mbrojtëse gjatë punimeve të instalimit dhe të mirëmbajtjes.
	Mirëmbajtja duhet kryer nga një person i kualifikuar në përputhje me udhëzimet në manualin e mirëmbajtjes.
	Respektoni udhëzimet e manualit të përdorimit gjatë punës.

tab. 113

1.2 Këshilla të përgjithshme sigurie

Udhëzime për grupin e synuar

Ky manual synohet për përdoruesit e sistemit të kondicionerit. Duhet të respektohen udhëzimet në të gjitha manualët në lidhje me impiantin. Në rast mosrespektimi mund të rezultojnë dëme materiale dhe lëndime në persona deri në rrezikim për jetën.

- ▶ Lexojini dhe ruajini manualët e përdorimit për të gjithë komponentët e sistemit përpara përdorimit.
- ▶ Respektoni këshillat e mëposhtme të sigurisë dhe të mirëmbajtjes.

Përdorimi në përputhje me qëllimin e duhur

Njësia e brendshme synohet për instalim brenda ndërtesës me lidhje drejt një njësie të jashtme dhe komponentëve të tjerë të sistemit, p.sh. rregullatorë.

Njësia e jashtme synohet për instalim jashtë ndërtesës me lidhje drejt një a më shumë njësive të brendshme dhe komponentëve të tjerë të sistemit, p.sh. rregullatorë.

Kondicioneri synohet vetëm për përdorim komercial/privat, ku devijimet e temperaturës nga vlerat e përcaktuara nuk shkaktojnë dëme për gjallesat apo materialet. Kondicioneri nuk është i përshtatshëm për rregullimin dhe ruajtjen precize të lagështirës së dëshiruar absolute.

Çdo përdorim tjetër konsiderohet në kundërshtim me përdorimin e parashikuar. Përdorimi i papërshtatshëm dhe dëmet si pasojë e këtij përjashtohen nga detyrimet tona.

Për instalimin në vende të posaçme (garazhe nëntokësore, salla tenike, ballkone apo në ambiente gjysmë të hapura):

- ▶ Fillimisht keni parasysh kërkesat për vendin e instalimit të përcaktuara në dokumentacionin teknik.

Rreziqet e përgjithshme nga freoni

- ▶ Kjo pajisje është e mbushur me freon. Gazi i freonit mund të shkaktojë gaze toksike kur bie në kontakt me zjarrin.
- ▶ Kontrolloni rregullisht sistemin nga një specialist i lecmsuar dhe lëreni të presë.
- ▶ Nëse ka dyshim për rrjedhje freoni, ajroseni mirë ambientin dhe njoftoni specialistin e miratuar.

Restaurimi dhe riparimet

Modifikimet e papërshtatshme të sistemit të kondicionerit mund të shkaktojnë lëndime dhe/ose dëmtime të pronës.

- ▶ Kryeni punime vetëm nga një kompani të licencuar.
- ▶ Mos u bëni modifikime njësisë së jashtme, të brendshme apo pjesëve të tjera të sistemit të kondicionerit.
- ▶ Hiqeni kondicionerin nga korrenti përpara të gjitha punëve të mirëmbajtjes.

Këshilla për administrimin e sistemit

Përdorimi i gabuar i kondicionerit mund t'ju cenojë shëndetin.

- ▶ Mos e ekspozoni trupin drejtpërdrejt në rrymën e ajrit për periudha të gjata kohe.
- ▶ Për foshnjat, fëmijët, të moshuarit, personat në shtrat apo invalidë, sigurohuni që temperatura e ambientit të jetë e përshtatshme për ata që ndodhen në ambient.
- ▶ Mos fusni kurrë sende në pajisje, mund të lëndoheni.

Keqpërdorimi i pajisjes mund të sjellë rënie të rendimentit, si dhe dëmtim të pajisjes dhe lëndim.

- ▶ Mos i bllokoni hyrjet dhe daljet e ajrit të pajisjeve.
- ▶ Mbyllini dyert dhe dritaret gjatë funksionimit.
- ▶ Mbrojeni njësinë e brendshme nga hyrja e ujit.
- ▶ Kontrolloni rregullisht skeletin e montimit të njësisë së jashtme për konsumim dhe fiksimin e duhur.
- ▶ Mos ushtroni peshë mbi njësinë e jashtme, p.sh. me objekte apo persona.

- ▶ Mbajini në minimum pluhurin, avujt dhe lagështinë në ambientin e instalimit të njësisë së brendshme.
- ▶ Mos përdorni gaze që digjen lehtësisht pranë pajisjeve, si p.sh. nga kënaçet spërkatëse.
- ▶ Nëse diçka nuk ju duket në rregull me kondicionerin (p.sh. erë e djegur, kablo me defekt), ndalojeni funksionimin dhe hiqeni menjëherë nga korrenti.

Siguria e pajisjeve elektrike për përdorimin në shtëpi dhe për qëllime të ngjashme

Për mënjanimin e rreziqeve nga pajisjet elektrike vlejné në përputhje me EN 60335-1 standardet e mëposhtme:

„Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë mbi 8 vjeç ose nga persona me aftësi të kufizuara fizike, ndijore ose mendore, ose me mungesë përvoja dhe dijesh nëse ata mbahen nën vëzhgim ose udhëzohen në lidhje me përdorimin e sigurt të pajisjes dhe kuptojnë rreziqet që lindin nga përdorimi i saj. Fëmijët nuk lejohen të luajnë me pajisjen. Pastrimi dhe mirëmbajtja nga ana e përdoruesit nuk lejohet të kryhet nga fëmijët pa qenë nën vëzhgim.“

„Nëse dëmtohet linja e lidhjes në rrejt, ajo duhet zëvendësuar nga prodhuesi ose shërbimi i tij i klientit ose një person me kualifikim të ngjashëm, për të mënjeluar rreziqet.“

1.3 Shënime të këtë manual


Figurat mund të gjenden të përmbledhura në fund të këtij manuali. Teksti përmban referenca për tek ilustrimet.

Produktet mund të ndryshojnë në varësi të modelit të shfaqur në këtë manual.

2 Të dhëna për produktin

2.1 Deklarata e konformitetit

Ndërtimi dhe funksionimi i këtij produkti është në përputhje me direktivat evropiane dhe kriteret plotësuese këmbëtare.

 Me markimin CE shpjegohet konformiteti i produktit me të gjitha rregullat e zbatueshme ligjore të BE-së, të cilat parashikojnë vendosjen e këtij markimi.

Teksti i plotë i deklaratës së konformitetit është i disponueshëm në internet: www.bosch-homecomfort.gr.

2.2 Të dhënat teknike të telekomandës

Ushqimi elektrik	2 bateri AAA
Rrezja e sinjalit	8 m
temperatura e lejueshme e ambientit	-5 °C ... 60 °C

tab. 114

2.3 Përdorimi me kondicioner Multisplit

Njësia e brendshme mund të përdoret në një sistem me kondicioner Multisplit. Në këtë rast, funksionet e mëposhtme janë joaktive:

- Funksionet e kursimit të energjisë **ECO** dhe **GEAR**
- Vetëpastrimi (I clean)
- Ulja e zhurmës (Silent Mode)
- Modaliteti manual
- Zbulimi i rrjedhjes së freonit
- Modaliteti automatik i kursimit të energjisë në modalitet gatishmërie (1 W standby)

2.4 Informacion për freonin

Kjo pajisje **përban gaze të fluorinuara të efektit serrë**, si p.sh. freon. Pajisja është e mbyllur hermetikisht. Informacioni për freonin sipas rregullores së BE-së nr. 517/2014 për gazet e fluorinuara të efektit serrë mund të gjendet në udhëzimet e përdorimit të pajisjes.



Shënim për instaluesin: Kur rimbushni me freon, plotësoni sasinë shtesë të mbushjes dhe sasinë totale të freonit në tabelën e „informacionit të freonit“ tek udhëzimet e përdorimit.


3 Përdorimi

3.1 Përmbledhje e njësive së brendshme

Legjenda për figurën 1:

- [1] Kapaku i sipërm
- [2] Hapësira për filtrin e vogël
- [3] Filtri i ajrit
- [4] Shpina e ekranit
- [5] Butoni për modalitetin manual
- [6] Fleta e ajrit

Ekрани i njësive së brendshme




Simboli	Shpjegim
Numri	Treguesi i temperaturës
	Lidhja WLAN ¹⁾ aktive
	Shfaqet në disa funksione kur aktivizohen. Tregon që është aktiv kohëmatësi i ndezjes kur njësia e brendshme është e fikur.
OF	Shfaqet në disa funksione kur janë të fikura.
dF	Shkrija automatike aktive
FP	Antifrizi aktiv: Njësia e brendshme e mban temperaturën e ambientit të paktën 8 °C.
CL	Funksioni i vetëpastrimit është aktiv (I clean)
Ex, Px, Fx	Kodi i gabimit („x“ është për çfarëdo shifre).

1) E mundshme vetëm me portëkalim IP si aksesori.

tab. 115 Simbolet në ekran

3.2 Përmbledhje e telekomandës


Butonat e telekomandës

























Poz.	Butoni	Funksioni
1		Aktivizo/çaktivizo.
	Mode	Caktoni modalitetin e funksionimit.
		Modaliteti ekonomik
2	SET	Zgjedhja e funksioneve të avancuara të punës.
	OK	Konfirmoni zgjedhjen.
		Konfiguroni kohëmatësin.
		Rrisni temperaturën.
		Ulni temperaturën.
3		Niveli i ventilatorit
	Swing	Caktoni funksionin e lëvizjes.
	Fresh	Funksioni i ajrit të pastër (Ionizer)
	Turbo	Ftohje/ngrohje e përshpejtuar
	LED	Fikeni ekranin e njësive së brendshme dhe sinjalizuesin e alarmit (Mute Mode).
	Clean	Vetëpastrimi (I clean)

tab. 116 Butonat e telekomandës

Treguesi në telekomandë



0010032826-002

Poz.	Simboli	Shpjegim
1		Funksioni i punës: Fluksi indirekt i ajrit është aktiv (Wind avoid me).
		Infografik: Vetëpastrimi është aktiv (I clean).
		Funksioni i punës: Funksioni i ajrit të freskët është aktiv (Ionizer).
		Funksioni i punës: Modaliteti i qetësimit është aktiv.
		Funksioni i punës: Funksioni i ndjekjes së personit është aktiv (Follow Me); Matja e temperaturës në telekomandë.
		Infografik: Funksioni i kontrollit me valë
		Infografik: Statusi i baterisë
2		Modaliteti i punës: Modalitet manual
		Modaliteti i punës: Modalitet ftohjeje
		Modaliteti i punës: Modalitet heqjeje të lagështisë
		Modaliteti i punës: Modaliteti i ngrohjes
		Modaliteti i punës: Modaliteti me ventilator
3		Treguesi i vlerës: Si rregull tregon temperaturën, shpejtësinë e ventilatorit ose (në rast aktivizimi të kohëmatësit) cilësimin e kohëmatësit.
		Infografik: Treguesi i transmetimit, ndizet kur telekomanda i dërgon një sinjal njësisë së brendshme.
		Infografik: Funksioni i kursimit të energjisë është aktiv.
		Infografik: Funksioni i kursimit të energjisë është aktiv.
		Infografik: Kohëmatësi i ndezjes/fikjes është aktiv.
		Infografik: Ulja e zhurmës është aktive (Silent Mode).
		Treguesi i vlerës: Tregon nivelin aktual të ventilatorit. Ka disa nivele fuqie (shirita) dhe cilësimin AUTO për kontroll automatik.
4		Infografik: Funksioni i lëvizjes automatike vertikal është aktiv (Iart/poshtë). Përndryshe shfaqet pozicioni aktual i fletëve të lëvizjes horizontale të ajrit.
		Infografik: Funksioni i lëvizjes automatike horizontale është aktiv (majtas/djathtas).
		Infografik: Ftohja/ngrohja e shpejtë është aktive.

tab. 117 Simbolet në ekran

3.3 Përdorimi i telekomandës

Rrezja e sinjalit është 8 m. Objektet që ndodhen midis apo që përdorin llamba të caktuara fluoreshente në të njëjtën hapësirë mund të ndikojnë në transmetimin e sinjalit.

- ▶ Drejtojeni telekomandën në dritaren marrëse të sinjalit të pajisjes dhe shtypni tastin e dëshiruar. Pajisja bën një bip kur merr një sinjal.


KËSHILLË

Funksionimi i duhur i telekomandës mund të pamundësohet përfundimisht.

- ▶ Mos e ekspozoni telekomandën në dritën e drejtpërdrejtë të diellit.
- ▶ Mos e lini telekomandën pranë një ngrohësi.
- ▶ Mbrojeni telekomandën nga lagështia dhe goditjet.

3.4 Caktimi i modalitetit kryesor të punës

Ndezja/fikja e pajisjes

- ▶ Shtypni butonin , për ta ndezur apo fikur pajisjen. Pajisja fillon në modalitetin e caktuar të punës.




Cilësimet mund të bëhen edhe kur është e fikur. Pajisja i ruan cilësimet edhe nëse shkëputet korrenti.



Pas fikjes, pajisja qëndron në gatishmëri. Teknologjia inteligjente e aktivizim-çaktivizimit mundëson një modalitet automatik kursimi energjie në modalitetin e gatishmërisë (1 W standby).

Modaliteti automatik





Në modalitetin automatik njësia kalon automatikisht mes modalitetit të ngrohjes dhe të ftohjes për të ruajtur temperaturën e dëshiruar.

- ▶ Shtypni butonin **Mode** derisa të shfaqet  në ekran.
- ▶ Rregulloni temperaturën e dëshiruar me butonat  dhe .





Në modalitetin automatik niveli i ventilatorit nuk mund të caktohet.

Modaliteti i ftohjes

- ▶ Shtypni butonin **Mode** derisa të shfaqet  në ekran.
- ▶ Shtypni butonin  derisa të arrihet shpejtësia e dëshiruar e ventilatorit.
- ▶ Rregulloni temperaturën e dëshiruar me butonat  dhe .

Modaliteti i ventilatorit

- ▶ Shtypni butonin **Mode** derisa të shfaqet  në ekran.
- ▶ Shtypni butonin  derisa të arrihet niveli i dëshiruar i ventilatorit. Për kontrollin automatik mund të zgjidhni **AUTO**.



Në modalitetin e ventilatorit temperatura nuk mund të caktohet apo shfaqet.





Modaliteti i heqjes së lagështisë

- ▶ Shtypni butonin **Mode** derisa të shfaqet  në ekran.



Në modalitetin e heqjes së lagështisë, niveli i ventilatorit nuk mund të rregullohet.

Funksioni i ngrohjes

- ▶ Shtypni **Mode** derisa të shfaqet  në ekran.
- ▶ Rregulloni temperaturën e dëshiruar me butonat  dhe .
- ▶ Shtypni butonin  derisa të arrihet shpejtësia e dëshiruar e ventilatorit.







Në temperatura shumë të ulëta të jashtme kapaciteti i ngrohjes i sistemit të kondicionerit mund të mos jetë i mjaftueshëm. Ne rekomandojmë të shtoni më shumë gjeneratorë ngrohjeje.





3.5 Konfigurimi i kohëmatësit

Kohëmatësit e ndezjes dhe të fikjes mund të caktohen nga 0 në 24 orë, për 10 orët e para me rritje 30-minutëshe, pastaj me rritje 1-orëshe. Caktimi në 0 orë e ndalon kohëmatësin.


Caktimi i kohëmatësit të ndezjes

- ▶ Shtypni butonin  derisa të shfaqet simboli .
- ▶ Shtypni butonin  ose  për të caktuar kohën e dëshiruar. Konfigurimi zbatohet pas një kohe të shkurtër.

Caktimi i kohëmatësit të fikjes

- ▶ Shtypni butonin  derisa të shfaqet simboli .
- ▶ Shtypni butonin  ose  për të caktuar kohën e dëshiruar. Konfigurimi zbatohet pas një kohe të shkurtër.

Anulimi i kohëmatësit

- ▶ Përdorni butonin  për të zgjedhur kohëmatësin e duhur.
- ▶ Caktoni 0.0 orë. Kohëmatësi ndalon pas një kohe të shkurtër.

Kombinimi i kohëmatësve

Dy kohëmatës mund të caktohen në të njëjtën kohë. Secili kohëmatës mund të programohet për t'u aktivizuar përpara tjetrit.

- ▶ Caktoni kohëmatësin e ndezjes dhe të fikjes. Cilësimet kombinohen automatikisht.

Ora aktuale	Ora 13:00
Caktimi i kohëmatësit të ndezjes	4,0 h
Caktimi i kohëmatësit të fikjes	8,5 h
Koha e ndezjes	Ora 17:00
Koha e fikjes	Ora 21:30

tab. 118 Shembull



Kohëmatësi i ndezjes dhe i fikjes nuk mund të programohet për vënien në punë të pajisjes në temperatura të ndryshme apo cilësime të tjera.

3.6 Funksione të tjera


3.6.1 Caktimi i funksionit të lëvizjes

KËSHILLË

Nëse fletët e lëvizjes së ajrit mbeten në pozicionin më të ulët gjatë modalitetit të ftohjes për një periudhë të gjatë kohe, mund ketë rrjedhje kondensati. Rregullimi manual i fletëve të lëvizjes së ajrit mund të shkaktojë interferencë.

- ▶ Për të rregulluar fletët e lëvizjes së ajrit përdorni vetëm telekomandën.


Lëvizja automatike vertikale (lart/poshtë)

- ▶ Shtypni butonin **Swing** deria të shfaqet simboli .
- ▶ Për të ndaluar lëvizjen automatike vertikale: shtypni sërish butonin **Swing**.


Rrotullojini me dorë fletët e lëvizjes së ajrit (lart/poshtë)

- ▶ Shtypni butonin **Swing** derisa të caktohet pozicioni i dëshiruar.

Cilësimi ndryshon sipas radhës së mëposhtme:



Lëvizja automatika horizontale (majtas/djathtas)

- ▶ Shtypni e mbani butonin **Swing** për mbi 2 sekonda, për të aktivizuar lëvizjen automatike horizontale. Telekomanda tregon simbolin .
- ▶ Për të ndaluar lëvizjen automatike horizontale: shtypni sërish butonin **Swing**.

Pozicioni i pastrimit

Për pastrim më të thjeshtë, fletët e lëvizjes së ajrit mund të vendosen në një pozicion të posaçëm (në varësi të modelit).

- ▶ Kur fiket pajisja, shtypni e mbani njëherësh për një sekondë butonin **Mode** dhe **Swing**.
- ▶ Për të dalë nga pozicioni i pastrimit: shtypni e mbajni sërish të dy butonat.

3.6.2 Çelësi i ekranit dhe i sinjalizuesit të alarmit (Mute Mode)


- ▶ Për ta ndezur apo fikur ekranin në njësinë e brendshme dhe sinjalizuesin e alarmit: Shtypni tastin **LED**.
- ▶ Për të shfaqur temperaturën aktuale të ambientit: mbani butonin **LED** për 5 sekonda.
- ▶ Për të shfaqur temperaturën e caktuar: Mbani shtypur për 5 sekonda të tjera tastin **LED**.

3.6.3 Funksionet e kursimit të energjisë



Funksionet e kursimit të energjisë mund të zgjidhen vetëm në modalitetin e ftohjes.

Pajisja ka funksionet e mëposhtme të kursimit të energjisë prej nga mund të zgjidhni:

- **ECO**: funksionim me fazën e ventilatorit **AUTO** dhe temperaturë të rregulluar për së paku 24 °C
- **GEAR** (75%): Ulni konsumin e energjisë me 25%
- **GEAR** (50%): Ulni konsumin e energjisë me 50%
- Asnjë prej simboleve të mësipërme: funksionim normal
- ▶ Për të aktivizuar një funksion kursimi energjie, shtypni tastin  derisa të shfaqet funksioni i dëshiruar.




Funksioni **ECO** cakton automatikisht 24 °C, nëse temperatura e caktuar më parë ishte më e ulët. Funksioni çaktivizohet sapo temperatura bie nën 24 °C.

3.6.4 Ulja e zhurmës (Silent Mode)

Ky funksion ul zhurmën e njësisë së brendshme dhe të jashtme gjatë funksionimit. Është veçanërisht i dobishëm nëse nuk doni të shqetësoni fqinjët gjatë natës.

- ▶ Gjatë funksionimit shtypni butonin  për 2 sekonda.

Për të ndaluar funksionin:

- ▶ Shtypni sërish butonin  për 2 sekonda.

-ose-

- ▶ Shtypni butonin , butonin **Mode**, butonin **Turbo** ose butonin **Clean**.



Për shkak të funksionimit me frekuencë të ulët të kompresorit, fuqja e ftohjes/ngrohjes mund të mos arrihet gjatë funksionimit të qetë të njësisë së jashtme.

3.6.5 Ftohje/ngrohje e përshpejtuar

Kur ftohni/ngrohni shpejt njësi e jashtme punon në fuqi maksimale për ta ngrohur ose ftohur shpejt ambientin.

- ▶ Ftohja e shpejtë: aktivizoni modalitetin e ftohjes dhe shtypni butonin **Turbo**.
- ▶ Ngrohja e shpejtë: aktivizoni modalitetin e ngrohjes dhe shtypni butonin **Turbo**.

Për të ndaluar funksionin:

- ▶ Shtypni sërish butonin **Turbo**.

3.6.6 Vetëpastrimi (I clean)

Pajisja ka një funksion për vetëpastrimin e avulluesit. Vetëpastrimi ngrin pluhurin, mykun dhe yndyrën. Në vijim çdo gjë shkrihet dhe thahet shpejt me ajër të nxehtë.

- ▶ Për të aktivizuar vetëpastrimin: shtypni tastin **Clean**. Gjatë vetëpastrimit, ekrani i njësisë së brendshme tregon **CL**. Pas 20 deri në 45 minutash vetëpastrimi mbaron automatikisht.

3.6.7 Mbrojtja ndaj ngricës (8 °C Heating)

Mund të aktivizohet kundërngirja për ta mbajtur temperaturën e ambientit së paku 8 °C.


- ▶ No modalitetin e ngrohjes 2x shtypni brenda 1 sekonde butonin **∇**. Pajisja qëndron fikur derisa temperatura të bjerë nën 8 °C.

Për të ndaluar funksionin:






- ▶ Shtypni butonin **⏻**, butonin **Mode**, butonin **Turbo** ose butonin **Clean**.

3.6.8 Kyçja e tasteve

Blokimin e butonave mund të përdoret për bllokimin e butonave të telekomandës.

- ▶ Për të aktivizuar/çaktivizuar bllokimin e butonave: shtypni njëherësh butonat **Clean** dhe **Turbo** për 5 sekonda. Kur është aktiv bllokimi i butonave, ekrani tregon simbolin .

3.6.9 Funksionet e avancuara të punës

- ▶ Shtypni butonin **Set**.
- ▶ Zgjidhni funksionin me butonin **Set** ose butonin **^, ∇**.
 -  = Fluks indirekt i ajrit
 -  = funksioni i ajrit të pastër
 -  = funksioni i modalitetit të gjumit
 -  = funksioni i ndjekjes së personit
 -  = funksioni i komandimit me valë
- ▶ Konfirmoni zgjedhjen me butonin **OK**.

Për të ndaluar funksionin:

- ▶ Përsëritni hapat nga më lart.

Fluks indirekt i ajrit (Wind avoid me)

Ky funksion parandalon fryrjen e ajrit direkt drejt trupit.



Funksioni ofrohet vetëm në modalitet ftohjeje, heqjeje lagështie dhe ventilatori.

Funksioni i ajrit të pastër (Ionizer)

Në hapësirë çlirohen jone për të vepruar kundër ndotësve të ajrit si p.sh. mykut, viruseve dhe alergjenëve.

Puna e natës

Ky funksion përdoret për kursimin e energjisë gjatë periudhave të pushimit. Pas një ore, pajisja ngroh ose ftoh më pak. Për këtë qëllim temperatura ndryshohet me 1 °C. Pas dy orësh, temperatura e caktuar ndryshon edhe me 1 °C. Në vijim qëndron në temperaturën e re.



Funksioni nuk ofrohet në modalitetin e heqjes së lagështisë dhe të ventilatorit.

Funksioni i ndjekjes së personit (Follow Me)

Ky funksion aktivizon telekomandën në pikën aktuale për të matur temperaturën me interval 3 minutash. Njësia e brendshme tani komandohet në bazë të këtyre matjeve.



Funksioni ofrohet vetëm në modalitetin e ftohjes, ngrohjes dhe automatik.

Funksioni i komandimit me valë

Ku funksion përdoret për të vendosur një lidhje përmes WLAN. Nëse pajisja nuk e tregon funksionin, duhet shtypur shtatë herë rresht butoni **LED**.



Për lidhjen me WLAN nevojitet një portëkalim i integruar IP (aksesor).

4 Zgjidhja e problemeve

4.1 Gabimet me tregues (Self diagnosis function)

Nëse ndodhin gabime gjatë funksionimit, llambat pulsojnë për një periudhë të zgjatur kohe ose ekrani tregon një kod gabimit (p.sh. EH 02).

Nëse ndodh një gabim për më shumë se 10 minuta:

- ▶ Ndërprisni korrentin për pak dhe ndizeni sërish njësinë e brendshme.

Kur një defekt nuk mund të mënjanohet:

- ▶ Telefonojini shërbimit të klientit dhe jepini kodin e gabimit dhe të dhënat pajisjes.

4.2 Gabime pa tregues

Nëse ndodhin gabime gjatë funksionimit të cilat nuk mund të shmangen:

- ▶ Telefonojini shërbimit të klientit dhe raportoni gabimin dhe të dhënat e pajisjes.

Problemi	Shkaku i mundshëm
Rendimenti i njësisë së brendshme është shumë i dobët.	Temperatura e caktuar është shumë e lartë ose e ulët. Filtri i ajrit është i ndotur dhe duhet pastruar. Ndikim i pafavorshëm i ambientit mbi njësinë e brendshme, p.sh. për shkak të pengesave përpara daljeve të ajrit të pajisjeve, për shkak të dyerve/dritareve të hapura në ambient apo për shkak të burimeve të forta të nxehtësisë në ambient. Funksionimi me zhurmë të ulët është aktivizuar dhe pengon fuqinë e plotë.
Njësia e brendshme nuk ndizet.	Njësia e brendshme ka një mekanizëm mbrojtës kundër mbingarkimit. Rindezja e njësisë së brendshme mund të marrë 3 minuta. Kanë rënë bateritë e telekomandës. Është aktivizuar kohëmatësi.
Modaliteti i punës ndryshon nga ftohja apo ngrohja në modalitet ventilatori.	Njësia e brendshme ndryshon modalitetin e punës për të parandaluar formimin e brymës. Temperatura e caktuar arrihet përkohësisht.
Njësia e brendshme krijon mjegull të bardhë.	Në rajone me lagështirë, diferenca e madhe në temperaturë mes njësisë së brendshme dhe ajrit të kondicionuar mund të shkaktojë mjegull të bardhë.
Njësia e brendshme dhe njësia e jashtme krijojnë mjegull të bardhë.	Nëse modaliteti i ngrohjes punon direkt pas shkrirjes automatike, mund të krijohet mjegull e bardhë për shkak të lagështisë së shtuar.
Njësia e brendshme dhe e jashtme bëjnë zhurmë.	Një zhurmë si fishkëllimë në njësinë e brendshme mund të ndodhë kur rrjeta e ajrit rivendos pozicionin e vet. Një fishkëllimë e lehtë gjatë funksionimit është normale. Kjo shkaktohet nga rrjedhja e freonit. Një zhurmë kërcitëse mund të ndodhë kur pjesët metalike dhe plastike të pajisjes brymehen apo tkurren gjatë ngrohjes/ftohjes. Njësia e jashtme bën zhurma të ndryshme gjatë punës, që janë normale.
Njësia e brendshme ose e jashtme lëshon pluhur.	Për periudha të gjata të lëna pa punë mund të mbledhet pluhur në pajisje nëse nuk e mbulon.
Erë jo e mirë gjatë funksionimit.	Erërat e këqija nga ajri mund të penetrojnë e të përhapen nëpër pajisje. Filtri i ajrit mund të ketë marrë myk dhe duhet pastruar.
Ventilatori i njësisë së jashtme nuk punon gjithë kohës.	Për funksionim optimal, ventilatori kontrollohet me tjetër formë.
Funksionimi është i çrregullt ose i paparashikueshëm ose njësia e brendshme nuk reagon.	Interferenca nga stacionet celulare ose amplifikatorët e sinjaleve të palëve të treta mund të ndikojnë mbi njësinë e brendshme. ▶ Shkëputeni dhe rinisni njësinë e brendshme për një kohë të shkurtër.
Penda e ajrit ose fleta e lëvizjes së ajrit nuk lëviz siç duhet.	Penda e ajrit ose fleta e lëvizjes së ajrit është rregulluar me dorë ose nuk është montuar siç duhet. ▶ Fikeni njësinë e brendshme dhe kontrolloni nëse komponentët janë kyçur mirë në vend. ▶ Ndizni njësinë e brendshme.

tab. 119

5 Mirëmbajtja



KUJDES

Rreziku nga elektroshoku ose pjesët lëvizëse

- ▶ Hiqeni nga korrenti përpara të gjitha punimeve të mirëmbajtjes.
- ▶ Hapat e mirëmbajtjes që nuk përmenden këtu kryejini vetëm nga një kompani e specializuar e miratuar.

5.1 Ndërrimi i baterive

Ju duhen 2 bateri të madhësisë AAA. Nuk rekomandohet përdorimi i baterive të karikueshme.

- ▶ Hiqni kapakun e folesë së baterive (→ figura 2).
- ▶ Futni bateritë e reja dhe kushtojini kujdes polaritetit të saktë.
- ▶ Rivendosni kapakun e folesë së baterive.

5.2 Pastrimi i pajisjes dhe i telekomandës

KËSHILLË

Pajisja mund të dëmtohet nëse nuk pastrohet saktë!

- ▶ Mos e spërkatni e mos i hidhni ujë drejtpërdrejt.
- ▶ Mos përdorni ujë të ngrohtë, pluhur abraziv apo solucione të forta.
- ▶ Fshijeni njësinë e brendshme dhe telekomandën me një leckë të butë.
- ▶ Pastrojeni njësinë e jashtme vetëm nga një kompani e specializuar e miratuar.

5.3 Pastrimi i filtrave të ajrit

KËSHILLË

Filtri i ajrit mund të deformohet nën dritën e drejtpërdrejtë të diellit.

- ▶ Mos i ekspozoni filtrat e ajrit në dritën e drejtpërdrejtë të diellit.

Pastrojini filtrat e ajrit çdo 2 javë dhe përpara e pas lënies pa punë për kohë të gjata.

- ▶ Fikni njësinë e brendshme.
- ▶ Palosni kapakun e sipërm të njësisë së brendshme për lart.
- ▶ Shtyjeni filtrin e ajrit për lart dhe nxirreni (→ figura 3).
- ▶ Hiqini filtrat e vegjël të ajrit, nëse ka (→ figura 1, [2]).
- ▶ Pastrojini filtrat e vegjël të ajrit me një fshesë dore me korrent.
- ▶ Lajeni filtrin e madh të ajrit me ujë të ngrohtë dhe një detergjent të butë dhe thajeni në hije.
- ▶ Rivendosini filtrat e vegjël dhe filtrin e madh të ajrit.

5.4 Lënia pa punë për kohë më të gjatë

Përpara fikjes për kohë të gjatë:

- ▶ Pastrojini filtrat e ajrit.
- ▶ Aktivizoni vetëpastrimin e njësisë së brendshme me tastin **Clean**.
- ▶ Pas vetëpastrimit aktivizoni modalitetin e ventilatorit derisa njësia e brendshme të thahet.
- ▶ Fikeni pajisjen e brendshme dhe shkëputeni nga korrenti.
- ▶ Hiqini bateritë nga telekomanda.
- ▶ Mbrojini pajisjet nga pluhuri.

5.5 Modaliteti manual

KËSHILLË

Dëmtimi i pajisjes për shkak të përdorimit të papërshtatshëm

Funksionimi manual nuk synohet për përdorim të përhershëm.

- ▶ Përdoreni vetëm për provë apo në raste emergjence.
- ▶ Përdoreni vetëm për kohë të shkurtër.

- ▶ Fikni njësinë e brendshme.
- ▶ Palosni kapakun e sipërm të njësisë së brendshme për lart.
- ▶ Shtypni butonin e modalitetit të ftohjes manuale me një send të hollë:
 - Shtypni një herë: imponohet modaliteti automatik.
 - Shtypni dy herë: imponohet modaliteti i ftohjes.
 - Shtypni tri herë: njësia e brendshme fiket.
- ▶ Për të rikthyer funksionimin normal, përdorni telekomandën.

6 Mbrojtja e ambientit dhe hedhja

Mbrojtja e ambientit është një parim i korporatës së grupit Bosch. Cilësia e produkteve, kursimi dhe mbrojtja e ambientit janë për ne objekte të të njëjtit nivel. Ligjet dhe rregulloret në lidhje me mbrojtjen e ambientit respektohet me rigozitet.

Për mbrojtjen e ambientit, duke marrë parasysh pikëpamjet ekonomike, përdorim teknologjinë dhe materialet më të mira të mundshme.

Paketimi

Në rastin e paketimit ne përfshihemi në sistemet e riciklimit sipas specifikave të vendit përkatës, për të garantuar një riciklim optimal. Të gjitha materialet e përdorura për paketimin nuk janë të dëmshme për ambientin dhe mund të riciklohen.

Pajisja e vjetër

Pajisjet e vjetra përmbajnë materiale me vlerë që mund të riciklohen. Pjesët mund të ndahen lehtë. Plastikak janë etiketuar. Në këtë mënyrë, pjesët e ndryshme mund të klasifikohen, të riciklohen ose të hidhen.

Pajisjet e vjetra elektrike dhe elektronike



Ky simbol do të thotë që produkti nuk duhet të hidhet me mbeturina të tjera, kundërshtuar duhet të dërgohet në pikat e grumbullimit të mbeturinave për trajtim, grumbullim, riciklim dhe asgjësim.

Simboli është i vlefshëm në shtetet ku zbatohen rregulloret për mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike, p.sh. "(MB) Rregulloret e mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike 2013 (të ndryshuara)". Këto rregullore përcaktojnë kuadrin për kthimin dhe riciklimin e pajisjeve të vjetra elektronike që zbatohet në secilin shtet.

Meqenëse pajisjet elektronike mund të përmbajnë substanca të rrezikshme, ato duhet të riciklohen me përgjegjësi në mënyrë që të minimizohet çdo dëm i mundshëm në mjedis dhe shëndetin e njeriut. Për më tepër, riciklimi i mbetjeve elektronike ndihmon në ruajtjen e burimeve natyrore.

Për informacion shtesë mbi asgjësimin ekologjik të pajisjeve të vjetra elektrike dhe elektronike, ju lutemi të kontaktoni autoritetet përkatëse lokale, shërbimin tuaj të hedhjes së mbeturinave shtëpiake ose shitësin me pakicë ku keni blerë produktin.

Mund të gjeni më shumë informacion këtu:

www.bosch-homecomfortgroup.com/en/company/legal-topics/weee/

Bateritë

Bateritë nuk duhen hedhur me mbeturinat e shtëpisë. Bateritë e përdorura duhen hedhur në sistemet lokale të grumbullimit.

Freon R32




Pajisja përmban gaz të fluorinuar efektiv R32 (potenciali i efektit serrë 675¹) me djegshmëri dhe toksicitet të ulët (A2L ose A2).


Sasia e përmbajtur përcaktohet në pllakën e markës së njësisë së jashtme.

Freoni është rrezik për mjedisin dhe duhet grumbulluar e hedhur veçmas.


1) sipas shtojcë I të rregullores (BE) Nr. 517/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 16 prillit 2014.



1



2



3